



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.57/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevi anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, për shkak të vendosjes së posterave në rrugë publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**PRANOHEN** si të bazuara ankesat e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,200.00 (dymijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

PZAP-i me datën 05.06.2017, ka pranuar dy ankesa, ankesën Anr 57/2017 të parashtruar nga Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe ankesën Anr 66/2017 të parashtruar nga subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV) në të cilat pretendojn se me datën 05.06.2017 kanë vërejtur se tek rrethrotullimi kryesor në hyrje të Prishtinës- rrugë publike kanë qenë të vendosur postera të kandidatëve për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, veprime këto që kualifikohen si shkelje të dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së dhe 4.1 pika b) i Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013. Ankuesit në mbështetje të pretendimeve në ankesa si provë materiale lidhur me rastin në fjalë kanë bashkangjitur fotografi të printuara dhe CD.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me nr.Anr 57/2017 për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017, koalicioni PDK-AAK-NISMA thekson se shkeljet nuk janë të qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivist të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore, prandaj lidhur me këtë koalicioni PDK-AAK-NISMA ka evituar shkeljet dhe ka ndermar te gjitha veprimet duke i larguar te gjitha ato nga vendi ku kane qene te vendosura. Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se janë larguar posterat nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesat vlerësoi se:

### **Ankesat janë të bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatit për deputet nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA janë vendosur në rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike.*

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që tek rrethrotullimi kryesor në hyrje të Prishtinës- rrugë publike kanë vendosur postera të kandidatëve për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni PDK-AAK-NISMA, në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti kanë përsëritur shkeljen e njejtë. Po ashtu si rrethanë, Paneli e mori edhe faktin se koalicioni në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se, brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterët nga vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr.57/2017 më datën 06.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.